



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**KRYETARI**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_

**V E N D I M**

**Nr. 89, Datë 29.07.2021**

**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË ZONAVE TË MBROJTURA TIRANË  
“MBI AUDITIMIN E LIGJËSHMËRISË DHE RREGUELLSHMËRISË”,  
për periudhën nga data 01.01.2019 deri më datën 31.03.2021.**

Nga auditimi i ushtruar në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, si dhe në tre AdZM në Qarqe përkatësisht AdZM Berat , Fier dhe Lezhe sipas programit të auditimit nr.402/2, datë 05.05.2021 Tiranë, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2019 deri me datë 30.03.2021, për vlerësimin e veprimtarisë financiare me kuadrin rregullator në fuqi, duke vlerësuar nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin për buxhetin, me aktet përkatëse ligjore e nën ligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore për menaxhimin e zonave të mbrojtura rezultoi që veprimtaria e subjektit të audituar, nuk ka qenë plotësisht efektive, si rrjedhojë e mangësive në zbatimin e procedurave në përputhje me kuadrin ligjor.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit,

**V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë në aktivitetin ekonomik financiar, zbatimin e projekteve me financim buxheti dhe donatorë vendas e të huaj, monitorimi e mbrojtja e mjedisit në zonat e mbrojtura”, të ushtruar në AKZM Tiranë me programin e auditimit nr.402/1, datë 05.05.2021, për periudhën 01.01.2019 deri me datë 30.03.2021.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

### **A. OPINIONI I AUDITIMIT**

#### ***Opinion mbi përputhshmërinë: (I pamodifikuar me theksim të çështjes)***

*Është kryer auditimi i përputhshmërisë së veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të zonave të Mbrojtura, sipas VKM NR. 102, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të administrative rajonale të zonave të mbrojtura).me Ligjin nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura”*

*Në opinionin tonë, bazuar në punën e kryer të auditimit ka rezultuar se aktiviteti i Agjencisë Kombëtare të zonave të Mbrojtura krijuar me VKM NR. 102, datë 04.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të administrative rajonale të zonave të mbrojtura).është në përputhje në të gjitha aspektet materiale me Ligjin nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura ”;*

#### **Baza për opinionin**

*Auditimi është kryer në përputhshmëri me ligjin nr.154/2014, miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” në përputhje me (ISSAI 4100)<sup>1</sup>Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, Manuali i Auditimit Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 66, datë 23.06.2020. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2008, të Kryetarit të KLSH-së.*

*Ne besojmë se evidencat e auditimit janë të mjaftueshme dhe krijojnë bazën e arsyeshme për dhënien e opinionit I pamodifikuar (me theksim të çështjes). Dhënien e opinionit I pamodifikuar (me theksim të çështjes) e mbështesim në konkluzionet e mëposhtme të arritura në përfundim të procesit të auditimit për marrjen e masave në zgjidhjen e çështjeve të mëposhtë:*

*Ne kemi audituar pajtueshmërinë e veprimtarisë së AKZM Tiranë me:*

- ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 òKodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar,*
- ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,*
- udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".*
- VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publik, i ndryshuar.*
- Ligji Nr.10296, datë 08/07/2010, òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.*
- Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në njësitë e sektorit publik.*
- Ligji nr.8402, datë 10.9.1998 òPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit.*
- Udhëzimi i KM nr. 3, datë 15.02.2001, Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit, i ndryshuar.*
- VKM nr. 243, datë 15.05.1995 òPër shpenzimet për pritje-përcjellje të delegacioneve të huaja, i ndryshuar.*

*Opinionin i kualifikuar. Bazuar në auditimin e kryer, kemi konstatuar se përveç rasteve të mosrespektimit apo mospërputhjeve të shënuara në paragrafin Bazat për Opinionin e Kualifikuar, veprimtaria e AKZM Tiranë, është në përputhje, me të gjitha aspektet materiale, meligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”,*

<sup>1</sup>ISSAI 4100 - Objektiv i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet veçmas me auditimin e pasqyrave financiare.

udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", ligjin nr.10296, datë 08/07/2010, ÷Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik, etj..

***(I pamodifikuar me theksim të çështjes)***

Auditimi zbuloi disa raste të mosrespektimit dhe mospërputhjeve ligjore, që rezultojnë në shkallën e zbatueshme risë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë),

Në 2 raste, për shumën 383,280 lekë, janë kryer prokurime me vlerë të vogël në kushtet e mungesës së llogaritjes prej komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, të fondit për sasinë e punëve që do të prokurojë, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike/termat e referencës.

-Në 43 raste, janë pranuar fatura tatimore, në kushtet kur këto fatura nuk janë konfirmuar nga AKZM, në rubrikën e caktuar të faturës Blerësi/Klienti dhe si të tilla nuk plotësojnë kushtet për të qenë një dokument vërtetues i mirëfilltë dhe në 1 rast nuk ka proces-verbal të marrjes në dorëzim të punimeve.

-Në 1 rast janë bërë ndryshime nga preventivi në situacion në një vlerë 4,989,897 lekë, ku nuk ka proces-verbale të mbajtura në mes operatorit ekonomik, mbikëqyrësit dhe AKZM-së dhe nuk është reflektuar me ndryshimet në kontratë dhe projekt.

-Institucioni për vitet 2019-2020, nuk kishte kryer inventarizimin fizik të magazinës, të llogarisë 211 ÷Pyje, Plantacione në bilanc 41,608,077, ndërsa për vitin 2020 dhe nuk është kryer inventarizimi fizik i llogarisë 213 ÷Rrugë, rrjete, vepra ujore në bilanc 23,684,492 lekë.

Nuk rezulton që komisioni të ketë bërë relacione përmbledhëse për drejtuesit e Institucionit për gjendjen e arkiveve materiale e jo material dhe nuk rezulton që komisioni të ketë bërë relacion përmbledhës për drejtuesit e Institucionit për gjendjen e aktiveve.

- Regjistri kontabël i aktiveve nuk ishte krijuar për llogaritë: 211-Pyje, Plantacione, llogari në bilancin e vitit 2020 me vlerë: 41,608,077 lekë dhe 213-Rrugë, rrjete, vepra ujore, llogari në bilancin e vitit 2020 me vlerë:23,684,492 lekë dhe 214 Instalime teknike, makineri e pajisje (ku përfshihet edhe inventari ekonomik) me vlerë në bilancin e vitit 2020 prej 484,497,378 lekë.

-Janë evidentuar mos akordime ndërmjet regjistrit të aktiveve dhe inventarëve përkatës, si në llogarinë 212 ÷Ndërtesa e Konstruksione, me një mos akordim 4 objekte ndërtimore për 2019 dhe 15 objekte në 2020; Në llogarinë 215 ÷Mjete Transporti ka një mos akordim prej 27 mjete transporti.

Lidhur me fletë daljet e magazinës, këtu nuk janë bashkëlidhur dokumentet shoqërues si urdhërdorëzime, fletëkërkesat, plani i shpërndarjes e kartelës limit.

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në 8 raste, për shumën 29,294 lekë, ka likuiduar DRSHTRR-të në rrethe për pagesa gjobash për vonesa, brenda vlerës së përgjithshme, sipas dokumenteve për taksa makine, gjoba për të cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës, për rrjedhojë nuk duhej të paguhej shuma prej 29,294 lekë nga AKZM.

-Nga AKZM, nuk është ndjekur asnjë procedurë administrative për ndjekjen e arkëtimeve nga detyrimet e prapambetura, në shumën 9,121,759 lekë për 8 subjektet që kanë kontrata të trashëguara ndër vite nga ish/DSHP óte, në kundërshtim me, ligji nr 44/2015, ÷Kodin e Procedurës Administrative si dhe Ligin nr.10296 datë 08.07.2010, ÷Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, ÷Kreu, II neni 8, germa g) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të parketuar dhe, në rastet kur nuk është i mundur të mbliidhet ky borxh, duhet të

ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligj.

- Në **11 raste**, janë legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik) me VKM Nr.16.date 03.04.2013. Ndërtimet pa leje nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar brenda një zone të mbrojtur ku zbatohet shkalla e tretë e mbrojtjes dhe në të cilën ndalohen ndërtime të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse.

AKZM për dënimet apo marrjet e vendimeve për kundërvajtje administrative për periudhën e audituar nga monitorimi I bërë nga AdZM në gjithë qarqet nuk rezultojnë të jene marra vendime për dënime administrative, për kundërvajtjet e parashikuara në neni 67,të këtij ligji sipas përcaktimeve ne legjislacionin në fuqi , por ne disa raste janë mbajtur procesverbale për konstatim kundra vajtje në zonat e mbrojtura, te trajtuar më lartë në material pra këto veprime bie në kundërshtim me ligjit nr.81/2018 òPër Zonat e Mbrojturaò, kreu X neni 67, kundërvajtja administrative, neni 68 vlerësimi I demit dhe neni 69 ,vendim për kundërvajtje.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve:**

Strukturat drejtuese të subjektit Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura (AKZM),janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Gjithashtu janë përgjegjës, për sa i takon shkallës së zbatueshme risë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria e subjektit.

Për parregullsitë e konstatuara në material mbajnë përgjegjësi sipas detyrave punonjësi të përcaktuara në rregullore të brendshme, si dhe sipas përgjegjësi qe përcaktohen në ligj.

### ***Përgjegjësitë e Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:***

Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të òAgjencisë Kombëtare të zonave të Mbrojturaò , me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe mbi përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticismin profesional në punën audituese.

Gjithashtu ne krijojmë një ide fillestare mbi kontrollin e brendshëm në mënyrë që të planifikojmë procedurat e auditimit që i përshtaten situatës aktuale.

Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që është identifikuar gjatë auditimit.

Audituesit identifikojnë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe përshkruhen në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë audituesit mendojnë që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në vitin 2021, ka një rritje të fondeve në vlerën **104,657 mijë lekë** ose 32 % shtesë fondesh, në krahasim me vitin 2020 Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në buxhetin e vitit 2021,krahasuar me buxhetin e vitit 2020 ka një rritje të fondeve të planifikuara në shpenzime operative në

vlerën 104,657 mijë lekë ose 32 %. Kjo shtesë e fondeve në planifikim ka pasur për qëllim përmirësimin e parqeve, infrastrukturës dhe kthimit të parkut natyror syri i kaltër në destinacion turistik etj. Ndërkohë, realizimi i këtij fondi në tremujorin e parë të vitit 2021, kundërt planifikimit paraqitet vetëm 14 %, cka tregon për një planifikim buxhetor të pa argumentuar dhe të pa studiuar mirë. *(Më hollësisht trajtuar në fq 21-26 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**1.1.Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, të hartojnë Projekt buxhete PB dhe PBA, parashikimin e numrit dhe të kostove të produkteve për realizimin e plotë të tyre në mënyrë që mos të rezultojë një situatë kontradiktore ku fondet e planifikuara dhe të alokuara të mos realizohen.

#### Në vijimësi

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga dokumentacioni i venë në dispozicion nga AKZM, rezulton:

- Në AKZM nuk ka një data-basë të përgjithshme mbi ndërtimet pa leje të në Zona të Mbrojtura.

- Kërkesa për legalizim të objekteve in formalë në Zona të Mbrojtura të ardhur nga ish/Drejtoritë Rajonale të ALUIZNI-t në Qarqe dhe ASHK janë minimale krahasuar me realitetin.

- Nuk ka komunikim shkresor me njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, Institucionet Ligj Zbatuese dhe ASHK-në në zbatim të nenit nr. 3 të ligjit 81/2017 òPër zonat e mbrojturaò për parandalimin e ndërtimit in formalë.Veprime në kundërshtim me nenin nr. 9 pika (ç) dhe (f) të ligjit Nr.81/2017 ò për Zonat e Mbrojturaò*(Më hollësisht trajtuar 95-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**2.1:Rekomandimi:** Njësite e Qeverisjes Vendore si institucion Ligj zbatues te krijojë Data ó Base mbi ndërtimet in formalë në Zonat e Mbrojtura si dhe zhvillojë një komunikim shkresor me njësitë e Vetëqeverisjes Vendore,Institucionet Ligj Zbatuese dhe ASHK-në për të parandaluar ndërtimet në ZM në shkallë vendi.

#### Në vijimësi

**3.Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, nuk kanë të regjistruara pronat e paluajtshme të shtetit në Zonat e Mbrojtura si dhe nuk ka kryer asnjë procedure ligjore për regjistrimin e pronave publike në Zonat e Mbrojtura, ne kundërshtim me nenit 3,4,6, 7, 8, 12 dhe 32 të ligjit Nr.8743, datë 22.2.2001 (i ndryshuar me ligjin nr. 9558/2006) òPër pronat e paluajtshme te shtetitò *(Më hollësisht trajtuar në faqet 95-99 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**3.1.Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë të mare masat për evidentimin dhe regjistrimin në Kadastër të pronave publike të aprovuara me VKM në Zonat e Mbrojtura.

#### Në vijimësi

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në **11 raste**, janë legalizuar objekte që ndodhen brenda zonave të mbrojtura në të cilën ndalohen ndërtime të çdo lloji pa u pajisur më parë me leje mjedisi nga autoritetet përkatëse (Zona e Mbrojtur e Liqenit të Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Korintik miratuar me VKM Nr.16.date 03.04.2013) konkretisht lejet e legalizimit: nr.98-68-63,datë 23.05.2017, nr.986598, datë 26.11.2016, nr.98-69-31, datë 26.07.2017, nr.98-66-38, datë 21.12.2016, nr.986625,datë 15.12.2016, nr. 986682, datë 25.01.2017, nr.986563, datë 14.11.2016, nr.98-66-06, datë 28.11.2016, nr.9878916, datë 30.04.2018, nr.986877, datë 04.07.2016 dhe nr.986564, datë 14.11.2016.

Veprim në kundërshtim me VKM nr.280, datë 01.04.2015 i ndryshuar; pika 3 e nenit 9, pika 2 e nenit 5, dhe neni 19 ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 òPër zonat e mbrojturaò, i ndryshuar, pika 8 e nenit 4, dhe pikat òaò dhe òbò të nenit 84, dhe neni 3 pika (1 dhe 2) ligjin nr.111/2012, òPër menaxhimin e integruar të burimeve ujoreò, si dhe neni 49 të ligji nr.

81/2017 date 04.05.2017. (Më hollësisht trajtuar në faqet 95-99 të Projekt Raportit të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi :** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura Tiranë dhe ADZM Dibër të marrë masa dhe të bashkëpunoje me të gjitha institucionet ligj zbatuese për Zonave të mbrojtura me njoftime periodike shkresore pranë IKMT dhe ASHK për ndjekjen procedurave ligjore në të gjitha ato zona ku ka objekte të ndërtuara jashtë ligjit.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**5.Gjetje nga auditimi:** Në Zonën e Mbrojtur Liqeni i Ulzës dhe Zona e Mbrojtur Korab-Koritnik miratuar me VKM Nr.16.date 03.04.2013 janë te identifikuar **67 objekte** informale të ndërtuara të cilat janë në proces legalizimi

- Në Zonën e Mbrojtur Shirok dhe Velipojë rezulton se janë **31 objekte** të ndërtuara në zone të mbrojtur.

- Zona e Mbrojtur Pogradec sipas Vendimit të Këshillit të ministrave me Nr.80 datë 18.02,1999, në sipërfaqen 27301.05 ha ku nga të dhënat nga ish/Drejtoria Vendore ALUIZNI Pogradec me ndryshimet e reja ASHK Pogradec figuron në janë të ndërtuara në zone të mbrojtur **432 objekte** banimi, shtesa social ekonomike etj.

Nga AKZM nuk ka informacion për të gjitha ndërtimet në këto zonë, për identifikimin dhe ndjekjen e tyre sipas procedurave ligjore.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr.8906, datë 6.6.2002 ðPër zonat e mbrojtura, i ndryshuar, neni 9, pika 3, neni 5, pika 2 dhe neni 19; Rregulloren e brendshme të AKZM në nenin 4, nenin 29 pika 3,6,8 si dhe 12 të kësaj rregulloreje; me VKM nr.280, datë 01.04.2015 i ndryshuar; dhe Ligjin Nr.111/2012, ðPër menaxhimin e integruar të burimeve ujore, neni 4, pika 8 dhe neni 84, pika a dhe b dhe neni 3 pika (1 dhe 2) dhe neni 49 të ligji nr. 81/2017 date 04.05.2017 (Më hollësisht trajtuar në faqet 95-99 të Projekt Raportit të Auditimit)

**5.1.Rekomandimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura në bashkëpunim me AdZM Tiranë, Dibër, Korçë dhe Shkodër të hartojë një Data-Base me gjithë informacionet për ndërtimet informale dhe të marrë masa dhe të bashkëpunoje me të gjitha institucionet ligj zbatuese për Zonave të mbrojtura me njoftime periodike shkresore pranë IKMT dhe ASHK për ndjekjen procedurave ligjore në të gjitha ato zona ku ka objekte të ndërtuara jashtë ligjit.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**6.Gjetje nga auditimi:** AKZM në përputhje me legjislacionin në fuqi jep miratimin ose jo për pajisjen me certifikatë pronësie nga ASHK të ndërtimeve informale brenda zonave të mbrojtura, por nga auditimi konstatohet se në 7 dosje nuk ka dokumentacion argumentues ligjor si: verifikim nga specialistët përkatës; hartën e vendndodhjes me formatin dixhital (AGIS) për të vërtetuar pajisjen me leje mjedisore për të proceduar me lëshimin e certifikatës së pronësisë. Veprime në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 81 /2017 date 04.05.2017 dhe VKM 402 date 21.06 .2006 pika 4 (Germa ç) si më poshtë .

ó Në shkresën me nr.1124 Prot. datë 05.02.2019, e protokolluar ne AKZM me nr. 165 Prot. datë 06.02 1019, ku kërkohet informacion nga institucioni përkatës nga AKZM për ndërtimin e një objekti 1 (një ) katesh, e verifikuar nga specialistet e ASHK ku përshkruhet se ðObjekti ndodhet në Zonën e Mbrojtur B Katigoria V e ndërtuar nga zë.

Në përgjigjen e dhënë me nr.165/1 Prot. datë 21.02.2019 është shprehur pozitivisht për legalizimin **e objektit qe ndodhet ne zonën e mbrojtur, Bashkia Vlorë “Vjose-Nartë** Pra në dosje nuk ka as një dokument argumentues ligjor, verifikim nga specialistët përkatës si dhe hartën me formatin dixhital (GIS) për të argumentuar se ky objekt nuk ndodhet në zonën e mbrojtur sipas shkresës se ASHK.

- Në shkresën me nr.4205 Prot. datë 05.11.2019, e protokolluar në AKZM me nr.9511 Prot. datë 07.11. 1019, ku kërkohet informacion nga institucioni përkatës nga AKZM për ndërtimin e një objekti i ndërtuar ne DrilonóTushemisht, e verifikuar nga specialistet e

ASHK ku përshkruhet se **“Objekti ndodhet në Zonën e Rëndësisë Kombëtare e ndërtuar nga X**

Në përgjigjen e dhënë me nr.1448/1Prot. datë 02.12.2019 është shprehur pozitivisht për legalizimin e objektit që ndodhet në këtë zonë në Bashkinë Pogradec.

Pra në dosje nuk ka as një dokument argumentues ligjor, verifikim nga specialistët përkatës si dhe hartën me formatin dixhital ( AGIS) për të argumentuar se ky objekt **nuk ndodhet në Zonën e Rëndësisë së Veçantë sipas shkresës se ASHK.**

- Në shkresën me nr.2507 Prot. Datë 19.06.2020, e protokolluar në AKZM me nr.641 Prot. datë 24.06.2020, ku kërkohet informacion nga institucioni përkatës nga AKZM për ndërtimin e një objekti i ndërtuar në zonën e mbrojtur Pogradec, e verifikuar nga specialistet e ASHK ku përshkruhet se **Objekti ndodhet në zonën e mbrojtur të ndërtuar nga x**

Në përgjigjen e dhënë me nr.641/1Prot. datë 13.07.2020 është shprehur pozitivisht për legalizimin e objektit i ndërtuar dhe **nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedurave të legalizimit** të këtij objekti, që ndodhet në këtë zonën e Bashkinë Pogradec

Pra në dosje nuk ka as një dokument argumentues ligjor, verifikim nga specialistët përkatës si dhe hartën me formatin dixhital (AGIS) për të argumentuar se ky objekt **nuk ndodhet në Zonën e Rëndësisë së Veçantë sipas shkresës se ASHK.**

- Në shkresën me nr.3130 Prot. Datë 02.09.2020, e protokolluar ne AKZM me nr.921 Prot. datë 04.09.2020, ku kërkohet informacion nga institucioni përkatës nga AKZM për ndërtimin e një objekti i ndërtuar në zonën e mbrojtur Pogradec e cila është e shpallur si zonë e Trashëgimisë Botërore ( UNESCO), e verifikuar nga specialistet e ASHK ku përshkruhet se **Objekti ndodhet në zonën e mbrojtur të ndërtuar nga z.x**

Në përgjigjen e dhënë me nr.921/1Prot. datë 16.09.2020 është shprehur pozitivisht për legalizimin e objektit i ndërtuar, **o nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedurave të legalizimit të këtij objekti”,** që ndodhet në këtë zonë në Bashkinë Pogradec.

Pra në dosje nuk ka as një dokument argumentues ligjor, verifikim nga specialistët përkatës si dhe hartën me formatin dixhital (AGIS) per të argumentuar se ky **objekt nuk ndodhet në Zonën e Rëndësisë së Veçantë sipas shkresës se ASHK.**

- Në shkresën me nr.6649 Prot. Datë 22.09.2020, e protokolluar në AKZM me nr.6319 Prot. datë 23.09.2020, ku kërkohet informacion nga institucioni përkatës nga AKZM për ndërtimin e një objekti i ndërtuar në zonën e mbrojtur Dajt ó Tiranë të verifikuar nga specialistet e ASHK ku përshkruhet se **Objekti ndodhet në zonën e mbrojtur kategoria e II e shpallur sipas VKM. 402,datë 21.06.2006 të ndërtuar objekti nga z. Marko Sali Dajti .**

Në përgjigjen e dhënë me nr.994/1Prot. datë 09.10.2020 është shprehur pozitivisht për legalizimin e objektit të ndërtuar, **nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedurave të legalizimit të shtesës së objekti, që ndodhet në këtë zonë e Dajtit.**

Pra në dosje nuk ka as një dokument argumentues ligjor, verifikim nga specialistët përkatës si dhe hartën me formatin dixhital (AGIS) për të argumentuar se ky objekt ndodhet në Zonën e Mbrojtur dhe është i pajisur me **Leje Mjedisore** sipas VKM 402 date 21.06 .2006 pika 4 (Germa ç).

- Në shkresën me nr.6609 prot. Datë 21.09.2020, e protokolluar ne AKZM me nr.6302 prot. datë 22.09.2020, ku kërkohet informacion nga institucioni përkatës nga AKZM për ndërtimin e një objekti i ndërtuar në zonën e mbrojtur Dajt ó Tiranë të verifikuar nga specialistet e ASHK ku përshkruhet se **Objekti ndodhet në zonën e mbrojtur kategoria e II e shpallur sipas VKM. 402,datë 21.06.2006 të ndërtuar objekti nga . X.**

Në përgjigjen e dhënë me nr.989/1Prot. datë 09.10.2020 është shprehur pozitivisht për legalizimin e objektit të ndërtuar, nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedurave të legalizimit të shtesës së objekti, që ndodhet në këtë zonë e Dajtit.

Pra në dosje nuk ka as një dokument argumentues ligjor, verifikim nga specialistët përkatës si dhe hartën me formatin dixhital (AGIS) për të argumentuar se ky objekt ndodhet në Zonën e Mbrojtur dhe është i pajisur me leje sipas VKM 402 datë 21.06 .2006 pika 4 (Germa ç)si dhe me neni 49 të ligjit 81 /2017 date 04.05.2017.

- Në shkresën me nr.3030 Prot. Datë 20.08.2020, e protokolluar në AKZM me nr.856 Prot. datë 20.08.2020, ku kërkohet informacion nga institucioni përkatës nga AKZM për ndërtimin e një objekti i ndërtuar në zonën e Lin- Pogradecit të verifikuar nga specialistet e ASHK ku përshkruhet se ÷Objekti ndodhet në zonën e mbrojtur dhe në Programin IPA 2010 i Bashkimit Evropian dhe ndodhet në zonën panoramike, të ndërtuar nga .X

Në përgjigjen e dhënë me nr.856/1Prot. datë 08.09.2020 është shprehur **pozitivisht për legalizimin e objektit të ndërtuar**, nuk përbën pengesë për vazhdimin e procedurave të legalizimit të shtesës së objekti, megjithëse ÷kjo zonë është shpallur edhe si zonë e Trashëgimisë Botërore (UNESCO) dhe Zonë me Përparësi të Zhvillimit të Turizmit dhe të merret mendimi dhe nga institucioneve te tjera.

Pra në dosje nuk ka as një dokument argumentues ligjor, verifikim nga specialistët përkatës si dhe hartën me formatin dixhital (AGIS) për të argumentuar se ky objekt ndodhet në Zonën e Mbrojtur dhe është i pajisur me leje Mjedisore sipas VKM 402 date 21.06 .2006 pika 4 (Germa ç) Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 49 të ligjit 81 /2017 date 04.05.2017 dhe VKM 402 date 21.06 .2006 pika 4 (Germa ç).(Më hollësisht trajtuar në pikën faqet 84-99 të Projekt Raportit të Auditimit),

**6.1. Rekomandimi:**Agjencia Kombëtare të Zonave të Mbrojtura Tiranë të marrë masa për plotësimin e dokumentacionin e kërkuar ligjor në 7 raste për miratimet e dhëna për pajisjen me leje legalizime të ndërtimeve in formalë dhe në rastin e mos plotësimit të dokumentacionit ligjor të vepohet me njoftime shkresore pranë IKMT dhe ASHK për ndjekjen procedurave ligjore në objektet të ndërtuara në zona të mbrojtura pa dokumentacionin e kërkuar ligjor.

#### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**7.Gjetje nga auditimi:** AKZM nuk ka një inventar ose data-baseme te dhëna për florën dhe faunës në territorin e zonave të mbrojtura, veprim në kundërshtim me pikën 4/d, neni 38, ligji nr. 81/2017, ÷për Zonat e Mbrojturaö.

- Në AKZM nuk ka në rregullore një procedurë për ndjekjen, zbatimin dhe monitorimin e Planeve të Menaxhimit me qëllim rruajtjen dhe përmirësimin e gjendjes së ZM,

-Nuk ka nxjerrë të dhëna periodike mbi monitorimin vjetor të zbatimit të PM të zonave dhe publikimin e të dhënave periodike vjetore në faqen zyrtare elektronike të saj, si pjesë e rrjetit kombëtar të monitorimit të gjendjes së mjedisit, veprim në kundërshtim me nenin 43 dhe pikën 3, neni 60 të ligjit nr.81/2017, ÷Për Zonat e Mbrojturaö (Trajtuar hollësisht në faqet 95-116 të të Raportit Përfundimtare të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** AKZM të marrë masa për të krijuar data-base për florën e faunën për çdo zonë të mbrojtur në territorin e Shqipërisë si dhe të krijojë një regjistër me të dhënat e nevojshme për ndjekjen e situatës dhe zbatimin të planit të menaxhimit për çdo zonë mbrojtur në çdo AdZM.

#### **Menjëherë**

**8.Gjetje nga auditimi:**AKZM në bashkëpunimi me njësitë e qeverisjes vendore,nuk kishte kryer në mënyre të vazhdueshme bashkëpunim dhe shkëmbime informacioni për sipërfaqet të cilat gjenden ne zonat tëmbrojtura, veprim në kundërshtim me Kreun IV, neni 40 i Ligjit nr.81/2017 ÷Për Zonat e Mbrojturaö.

- Në AKZM,nuk ka të dhëna për bashkëpunime me Drejtoritë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës sidomos përsa i përket zonave ujore, të cilat gjenden në sipërfaqet e zonave të mbrojtura në lidhje me zbatimin e planit të menaxhimit për mbrojtjen e ujërave nga ndotjet dhe peshkimi i pa kontrolluar, veprime të cilat bien në kundërshtim me Ligjin Nr. 111/2012 ÷Për menaxhimin e integruar të burimeve ujoreö, dhe nenit 34 të ligjit nr.8906 datë



06.06.2002 òPër zonat e Mbrojturaö (Trajtuar hollësisht në faqet 151-180 tëRaportit Përfundimtare të Auditimit).

**8.1.Rekomandim:** AKZM dhe AdZM-të të marrin masa që brenda kuadrit ligjor dhe reciprocitetit institucional të kryejnë bashkëpunime me Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe Drejtoritë e Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës që ta ndalë procesin e degradimit dhe ndotjes si dhe përdorimin pa kriter e pa leje të peshkimit.

#### *Në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk është vendosur dhe nuk ekziston territori buferik i zonës së menaxhimit të habitoreve dhe llojeve me gjerësi 50 ml nga kufiri i zonës sipas nenit 3/30 të ligjit nr.81/2017, ku citohet: *“Zonë buferike” është hapësira e kufizuar, në periferi të zonës së mbrojtur mjedisore, që shërben për parandalimin ose zbutjen e ndikimeve ekologjiksht të dëmshme në mjediset dhe elementet e rëndësishme të zonës së mbrojturö.* Në rezervatet natyror të menaxhuar ku mungon zona buferike futen Kune Vain, Rrushkulli, Pishë Poro, Karaburuni (Trajtuar hollësisht në faqet 151-180 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).

**9.1.Rekomandim:** AKZM në bashkëpunim e koordinim me AdZM-të të marrë masa për të vendosur, caktuar dhe kufizuar sipas standardit ligjor zonat buferike në rezervatet natyrore Kune-Vain, Rrushkulli, Pishë Poro, Karaburun, Ksamil, Divjakë etj., në funksion të ruajtjes dhe përmirësimit të funksioneve natyrore të tyre.

#### *Menjëherë*

**10.Gjetje nga auditimi:** NëAKZM Tiranë emërimet dhe pranimet në punë nuk ishin kryer në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar òKod i punësö, në VKM nr.102, datë 04.02.2015, òPër krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojturaö në kreu V, pika 2, òProcedura e rekrutimitö përcaktohen se: *“Marrëdhëniet e punës së punonjësve të administratave të zonave të mbrojtura rregullohen sipas Kodit të Punës”;* pasi në pikën 3 shpreh: *“Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura miratohen nga Ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura , me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm”.*

Gjatë auditimit nuk u paraqit ndonjë dokument për Kriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura, i miratuar nga Ministri përgjegjës për zonat e mbrojtura, por as në rregulloren e AKZM *“Rregullorja e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe e Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura”*, miratuar me urdhrin nr.72/1, datë 15.06.2015 të Ministrit Mjedisit në të cilën përshkruhen detyrat për çdo vend pune, nuk përmenden kriteret për punësimin në AdZM (Trajtuar hollësisht në faqet 26-33 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).

**10.1.Rekomandimi:** Drejtori i Përgjithshëm i AKZM Tiranë të marrë masa dhe të përgatisë dhe të paraqesë për miratim tek Ministri dokumentin òKriteret dhe përshkrimi i vendeve të punës për punonjësit e administratave të zonave të mbrojtura (AdZM)ö.

#### *Menjëherë*

**11.Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi , në 8 rate nuk janë hartuar procesverbalet për llogaritjen e fondit limit, për òblerjet me vlera të voglaö, përpara nxjerrjes së urdhrin të prokurimit nga titullari i autoritetit kontraktor ose personi i autorizuar prej tij, veprime këto në kundërshtim me nenin 59 të VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikö i ndryshuar, Udhëzimit nr.30 date 31.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësite e Sektorit Publikö (Trajtuar hollësisht në faqet 106-154 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).

**11.1 Rekomandim;** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura të marrë masa, që gjatë përlllogaritjes së vlerës së fondit limit ti referohen kuadrit regullativ ligjor me qëllim llogaritjen e saktë të vlerës së kontratës.

### ***Menjëherë dhe në vijimësi***

**12. Gjetje nga auditimi:** Në Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të dy vitet 2019-2020, nuk janë mbajtur të dhëna analitike për të ardhurat dhe shpenzimet (ditarët e të ardhurave dhe shpenzimeve, ditari i veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, centralizatori / libri i madh). Mbahej vetëm ditari i Bankës dhe Magazinës

Në ditarin e Bankës, regjistrimet kontabël preknin vetëm llogaritë financiare dhe të shpenzimeve dhe jo të gjithë llogaritë. Kështu Pasqyrat financiare të vitit, ishin hartuar vetëm bazuar në Ditarin e Bankës dhe të Magazinës dhe shumë veprime si dhe nxjerrja e pasqyrave financiare bëhej nga jashtë (extra kontabël).

Përveç artikujve të magazinës, për të gjithë postet e tjera të pasqyrave financiare, nuk ishin përgatitur inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit.

Këto mosveprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme*", pika 28 (*Trajtuar hollësisht në faqet 33-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**12.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të hapë dhe të mbajë librat analitikë të ardhurave dhe shpenzimeve, ditarin e veprimeve të ndryshme, ditari i pagave, dhe të gjithë ditaret e tjerë, analizat, centralizatori / libri i madh.

Në ditarin e Bankës, regjistrimet kontabël të kryhen në llogaritë financiare dhe të llogarive të tjera, sipas veprimeve dhe ngjarjeve konkrete, dhe të mos kalohen në çdo rast direkt në shpenzime.

Për pasqyrat financiare, të përgatiten inventarët dhe analizat sipas posteve të bilancit.

### ***Në vijimësi***

**13. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitin 2019, nuk kishte kryer inventarizimin fizik të magazinës.

Nuk është paraqitur inventari kontabël dhe nuk është kryer inventarizimi fizik i llogarisë 211 ÷ Pyje, Plantacione në bilanc 41,608,077 lekë.

Llogaria 214-Instalime teknike, makineri e pajisje evidentohen në vlerën kontabël 51,554,331 lekë dhe fizik në vlerën 51,165,584 lekë me një diferencë më pak 388,747 lekë.

Për vitin 2019 nuk rezulton që komisioni të ketë bërë relacion përmbljedhës për drejtuesit e Institucionit mbi gjendjen e aktiveve materiale e jo materiale dhe nuk është ngritur komision për nxjerrje jashtë përdorimit dhe për ekzekutimin, në kundërshtim me nenin 6, germa (e) të Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010, ÷ Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, UMF nr.30, datë 27.12.2011, ÷ Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, i ndryshuar, pikat 104/c dhe 106.

Gjithashtu nuk rezulton të jete kryer ndonjë procedurë për vlerësimin e aktiveve sipas UMF nr.30, datë 27.12.2011 ÷ Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pika 95 (*Trajtuar hollësisht në faqet 33-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të rregullojë mos akordimet e përmendura në llogarinë 214-Instalime teknike, makineri e pajisje për diferencën 388,747 lekë.

Në të ardhmen pas kryerjes së inventarizimeve, komisioni të bëjë relacion përmbljedhës për drejtuesit e Institucionit mbi gjendjen e aktiveve materiale e jo materiale si dhe për diferencat e rezultuara dhe ngrihet komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit dhe për ekzekutimin e Aktiveve.

Institucioni çdo fund viti të përgatisë inventarët kontabël për të gjithë pasurinë në administrim të tij.

*Në bilancin e vitit 2021 dhe në*

*vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitin 2020:

-Nuk kishte kryer inventarizimin fizik të magazinës.

-Nuk është paraqitur inventari kontabël dhe nuk është kryer inventarizimi fizik i llogarisë 211 òPyje, Plantacione në bilanc 41,608,077.

-Nuk është paraqitur inventari kontabël dhe nuk është kryer inventarizimi fizik i llogarisë 213 òRrugë, rrjete, vepra ujore në bilanc 23,684,492 lekë.

Për vitin 2020 nuk rezulton të jete ngritur komision për nxjerrje jashtë përdorimit dhe për ekzekutimin dhe nuk rezulton që komisioni të ketë bërë relacion përmbledhës për drejtuesit e Institucionit për gjendjen e aktiveve materiale e jo material, në kundërshtim me nenin 6, germa (e) të Ligjit Nr.10296, datë 08/07/2010, òPër Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, UMF nr.30, datë 27.12.2011, òPër menaxhimin e aktiveve në sektorin publik, i ndryshuar, pikat 104/c dhe 106.

Gjithashtu nuk rezulton të jete kryer ndonjë procedurë për vlerësimin e aktiveve sipas UMF nr.30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik pika 95 (*Trajtuar hollësisht në faqet 63-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe të kryejë të gjithë inventarët fizikë duke përfshirë inventarizimin fizik të magazinës, inventarizimin fizik të llogarisë 211 òPyje, Plantacione në bilanc 41,608,077 dhe inventarizimin fizik të llogarisë 213 òRrugë, rrjete, vepra ujore në bilanc 23,684,492 lekë.

-Pas kryerjes së inventarizimeve, komisioni të bëjë relacion përmbledhës për drejtuesit e Institucionit mbi gjendjen e aktiveve materiale e jo materiale si dhe për diferencat e rezultuara dhe ngrihet komisioni për nxjerrje jashtë përdorimit dhe për ekzekutimin e Aktiveve.

Institucioni çdo fund viti të përgatisë inventarët kontabël për të gjithë pasurinë në administrim të tij, duke përfshirë inventarin e llogarisë 211 òPyje, Plantacione dhe llogarisë 213 òRrugë, rrjete, vepra ujore.

*Në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Ne lidhje me evidentimin, administrimin dhe dokumentimin e vlerave materiale e monetare, megjithëse ishte krijuar regjistri i kontabël i aktiveve, si për aktivet afatshkurtra ashtu edhe për ato afatgjata u konstatuan disa parregullsi, si:

- Regjistri kontabël i aktiveve nuk ishte krijuar për llogaritë: 211-Pyje, Plantacione, llogari në bilancin e vitit 2020 me vlerë: 41,608,077 lekë dhe 213-Rrugë, rrjete, vepra ujore, llogari në bilancin e vitit 2020 me vlerë: 23,684,492 lekë dhe 214ö Instalime teknike, makineri e pajisjeö (ku përfshihet edhe inventari ekonomik) me vlerë në bilancin e vitit 2020 prej 484,497,378 lekë.

-Për llogarinë 214ö Instalime teknike, makineri e pajisjeö (ku përfshihet edhe inventari ekonomik) me vlerë në bilancin e vitit 2020 prej 484,497,378 lekë, nuk ishte krijuar regjistri i aktiveve, por ishte mjaftuar vetëm me përmbledhëset e inventarëve kontabël e fizikë të paraqitur bashkëlidhur bilancit, në të cilat mungojnë disa nga kërkesat minimale si: data e hyrjes, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes.

-Për llogaritë 212 öNdërtesa e Konstruksioneö dhe 215 öMjete Transportiö, disa nga kërkesat minimale që duhet të përmbaje regjistri i aktiveve, ishin përgatitur në mënyrë të shpërndare,

ku një pjesë ishin evidentuar në një regjistër i cili na u paraqit në formë elektronike dhe pjesa tjetër gjendej bashkëlidhur me bilancet në përmbledhëset e inventarëve kontabël e fizikë të paraqitura. Pra regjistrimi i aktiveve paraqitet me parregullsi të theksuara në këtë drejtim.

Megjithatë edhe të përmbledhura, regjistri i aktiveve ka mangësi lidhur me plotësimin e kërkesave minimale siç janë: data e daljes në përdorim, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes.

Sa sipër është vepruar në mospërputhje me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò, Kreu III, pikat 26-33, veçanërisht pika 30.

*(Trajtuar hollësisht në faqet -33-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për krijimin dhe përmirësimin e regjistrit kontabël të aktiveve dhe të mos mjaftohet vetëm me përmbledhëset e inventarëve kontabël e fizikë të paraqitur bashkëlidhur bilancit.

Në kartelat e AAMGJ, të paraqiten sa më shumë të dhëna, ku kërkesat minimale të jenë: data e hyrjes, vlera e blerjes, data e daljes në përdorim, vlera e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhja, personi përgjegjës, koha e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlera e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes etj.

#### **Menjëherë**

**16. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të vitet 2019-2020, në 4 raste, ka kryer kontabilizimin e vendimeve gjyqësore që kanë kaluar në Gjykatën e Apelit, në shumën 3,132,776 lekë, në llogaritë e klasës 6, shpenzime të shfrytëzimit të viteve 2019-2020, në një kohë që duhej marrë në fund të viteve 2018 dhe 2019 në llogarinë e provizioneve, meqenëse vendimet e gjykatave kanë marrë formë të prerë, madje është angazhuar edhe përmbartuesi. Këto veprime dhe mosveprime janë në kundërshtim me udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, pika 34 *(Trajtuar hollësisht në faqet 33-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**16.1 Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe në çdo rast kontabilizimi të vendimeve gjyqësore që kanë kaluar në Shkallë të II-të (Gjykatën e Apelit), të bëhet në llogarinë e provizioneve.

#### *Në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të vitet 2019-2020, nuk ka kryer kontabilizime në llogarinë kontabël 218 òInventar ekonomikò e cila nuk është evidentuar në bilanc por është përfshirë brenda llogarisë 214 òInstalime elektrike, makineri e paisjeò, në moszbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, Aneksi 2.

*(Trajtuar hollësisht në faqet 33-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**17.1 Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për të ardhmen të kryejë kontabilizimet në llogarinë kontabël 218 òInventar ekonomikò, llogari që duhet të përfshihet në pasqyrat financiare.

#### *Në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitet 2019-2020, nuk ka kryer kontabilizime në llogaritë në fillim të vitit ushtrimor: Debi 520 òDisponibilitete në Thesarò dhe Kredi 476 òTë ardhura të caktuara për t'u përdorur si dhe në fund të vitit ushtrimor, për përdorimin e fondeve buxhetore korrent dhe kapitale, sipas situacionit të rakorduar me thesarin, nuk bëheshin veprimet me llog. 476, dhe 720 òGrant korrent i brendshëmò; 105 òTeprica e granateve kapitale të brendshme dhe 4342 òOperacione me shtetin (të drejta)ò, në kundërshtim me

Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

*(Trajtuar hollësisht në faqet 33-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**18.1.Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe të kryejë në fillim të vitit ushtrimor kontabilizime në llogaritë: Debi 520 të Disponibilitete në Thesarë dhe Kredi 476 të ardhura të caktuara për të përdorurë si dhe në fund të vitit ushtrimor, për përdorimin e fondeve buxhetore korrent dhe kapitale, sipas situacionit të rakorduar me thesarin, veprimet me llog. 476 dhe 720 të Grant korrent i brendshëm; 105 të Teprica e granteve kapitale të brendshme dhe 4342 të Operacione me shtetin (të drejta).

#### *Në vijimësi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitet 2019-2020, lidhur me librin e llogarive të magazinës, për Aktivet Qarkulluese, konstatohet se veprimet dhe ngjarjet e ndodhura, janë marrë në ditë dhe janë kontabilizuar si llogaria 603 të Ndryshimi i gjendjeve e cila prekej vetëm në të Debi për fletë-daljet, ndërsa për fletë-hyrjet prekej në të Kredi llogaria 401 të Furnitorëve, në një kohë që kjo llogari ka lidhje dhe kreditohet në debi të llogarisë së klasës 6 të shpenzimeve të shfrytëzimit.

Kontabilizimi i llogarisë 603 në debi, nuk bëhet për çdo fletë dalje, por kryhet vetëm një herë në muaj, në mënyrë të përmbledhur.

Veprimet e mësipërme janë në mospërputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"

*(Trajtuar hollësisht në faqet ---- të Projekt Raportit të Auditimit).*

**19.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me ditarin e llogarive të magazinës dhe të kryejë kontabilizimet e rregullta në llogaria 603 të Ndryshimi i gjendjeve e cila duhet të preket në të Debi dhe të Kredi me kundër parti llogaritë inventari ale të klasës 3 të Aktive Qarkulluese.

#### *Në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitet 2019-2020, lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit, në pasqyrat financiare nuk evidentohet shuma e akumuluar e amortizimit në llogaritë 209 dhe 219, nuk evidentohet llogaria 1013 por vetëm në pasqyrën nr. 4 si dhe në pasqyrën e performancës financiare Rubrika 7, Llogaria 681 të Kuotat e amortizimit të AAGJ, të shfrytëzimit. Llogaria nr. 681, për 2,117,814 lekë evidenton shumën vjetore të amortizimit.

Në aktivin e pasqyrave vjetore nuk paraqiten shumat e amortizimit të akumuluar 209 dhe 219, respektivisht për Aktivet afatgjata jo materiale dhe Aktivet afatgjata materiale, por paraqitja e AAGJM është evidentuar me vlerën neto të tyre (Kosto historike minus amortizimin e akumuluar), veprim ky që nuk është në përputhje me Udhëzimin të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 31. *(Trajtuar hollësisht në faqet 20-50 të Projekt Raportit të Auditimit).*

**20.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me paraqitjen e llogarive të amortizimit dhe në pasqyrat financiare të evidentojë shumat e akumuluar të amortizimit, në llogaritë 209 dhe 219, dhe të evidentohet llogaria 1013. Llogaria nr. 681, të evidentojë saktësisht shumat vjetore të amortizimit të AAGJ.

#### *Në vijimësi*

**21. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për vitet 2019-2020, ka përgatitur pasqyrat financiare ne te cilat ne disa raste rezultuan mos rakordime ndermjet llogarive, si më poshte:

-Për vitin 2019, llogaria 4342 ÷Te tjera operacione me shtetin (debitor)ö, në fund të vitit 2019 nuk kuadro me Llogarinë 7206 ÷Financim i pritshëm nga buxhetiö për diferencë 418,000 lekë (17,083,922 ó 16,665,922) sipas Pasqyrës së Performancës Financiare, duke mos përfshirë detyrimet e shtetit ndaj furnitorëve për vlerën 418,000 lekë, duke qenë në mospërputhje me UMF nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 32.

-Për vitin 2020,totali i shpenzimeve është 222,577,095 lekë, nuk rakordon me shifrën ne formatin 2, ku kjo shumë është 209,331,941 lekë , me një diferencë prej 13,245,154 lekë (Trajtuar hollësisht në faqet 33-63 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**21.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të rregullojë mos rakordimet e përmendura në totalin e shpenzimeve për diferencën 13,245,154 lekë.

#### *Në bilancin e vitit 2021*

**22. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), në 41 raste, ka qenë në kushtet e mosveprimit, duke pranuar fatura tatimore, si për pagese të subjekteve të ruajtjes fizike, për pagesa internet, parking, posta si dhe pagesa për investime të prokuruar, fatura për pagesa hotele, fatura për pagesa takse makine, etj., në kushtet kur këto fatura nuk janë konfirmuar nga AKZM, në rubrikën e caktuar të faturës Blerësi/Klienti dhe si të tilla nuk plotësojnë kushtet për të qenë një dokument vërtetues i mirëfilltë.Pra konstatohet se në përgjithësi dokumentet e paraqitura fatura tatimore nuk konfirmohen nga AKZM, mosveprime këto në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikö, nenet 34, 35, 36. (Trajtuar hollësisht në faqet 20-50 të Projekt Raportit të Auditimit).

**22.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe në asnjë rast të mos pranojë për likuidim fatura tatimore të cilat nuk janë konfirmuar nga AKZM, në rubrikën e caktuar të faturës Blerësi/Klienti dhe si të tilla nuk plotësojnë kushtet për të qenë një dokument vërtetues i mirëfilltë.

#### *Në vijimësi*

**23. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), në 1 rast, sipas urdhër-shpenzimit nr. 278, datë 01.10.2020, janë likuiduar 2,772,000 lekë, ÷Xö Shpk, Sistemi elektronik biletarie, sipas faturës tatimore nr. PO174, datë 30.09.2020, faturë e cila është plotësuar në rubrikën ÷Blerësiö vetëm me nënshkrimin e blerësit dhe jo me emër e mbiemër. Bashkëlidhur nuk ka proces-verbal të marrjes në dorëzim të punimeve, megjithëse gjendet urdhri nr. 161, datë 29.09.2020 për ngritjen e grupit të punës për marrjen në dorëzim të mallit, për postbllokun në Zonën e Mbrojtur të Kune-Vainit.

Sa sipër është vepruar në moszbatim të udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 42-50.(Trajtuar hollësisht në faqet 33-63 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**23.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen dhe në asnjë rast të mos pranojë për likuidim fatura tatimore për kontrata prokurimesh, të cilat nuk janë konfirmuar nga AKZM, në rubrikën e caktuar të faturës Blerësi/Klienti dhe si të tilla nuk plotësojnë kushtet për të qenë një dokument vërtetues i mirëfilltë

**Në vijimësi**

**24. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), në 1 rast, sipas urdhër-shpenzimit nr. 406, datë 14.12.2020, ka likuiduar 36,238,342 lekë, ÷Xö Shpk, Sistemim i zonës së pelegrinazhit Bektashian në Parkun Kombëtar Mali I Tomorit, duke zbritur 5 % garanci punimesh sipas faturës tatimore nr. 40, datë 14.12.2020, faturë e cila nuk është plotësuar në rubrikën ÷Blerësiö me emër e mbiemër por vetëm firmë. Bashkëlidhur faturës ndodhet përmbledhësja dhe stacionet e punimeve. Vlera totale e kontratës me TVSH është 51,927,274.8 lekë.

Nga auditimi konstatohet se në volumet e punimeve të kryera ka patuar ndryshime krahasuar me preventivin mbi bazën e të cilit është lidhur kontrata. Kështu vetëm në 1 rast, siç mund të përmendim në stacionin nr. 1 ÷Parkimiö zërin ÷Sipërfaqe e shtruar me elemente beton griliate t=8 cmö, ku volumi është ulur nga preventivi në situacion për 4536.27 m2 (8486.7-3950.43) dhe në një vlerë 4,989,897 lekë. Për këto ndryshime nuk ka proces-verbale të mbajtura në mes operatorit ekonomik, mbikëqyrësit dhe AKZM-së dhe nuk është reflektuar me ndryshimet në kontratë dhe projekt.

Sa sipër është në kundërshtim me ligjin nr.8402, datë 10.9.1998 ÷Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitö, si dhe me udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001, Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitö, i ndryshuar.(Trajtuar hollësisht në faqet 33-63 të të Raportit Përfundimtare të Auditimit).

**24.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa për të ardhmen lidhur me prokurimet e fondeve të ndërtimit dhe për çdo rast ndryshimi domethënës në volumet e punimeve të kryera nga preventive në stacione, të mbahen proces-verbale në mes operatorit ekonomik, mbikëqyrësit dhe investitorit (AKZM) duke reflektuar dhe duke bërë ndryshimet në kontratë dhe projekt.

#### **Në vijimësi**

**25. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), nuk kishte kryer rakordimet e nevojshme ndërmjet regjistrit të aktiveve dhe inventarëve përkatës. Kështu:

-Nga rakordimi i kryer për vitin 2019 në llogarinë 212 ÷Ndërtesa e Konstruksioneö, midis inventarit të paraqitur dhe regjistrin kontabël të AAGJM, konstatohet se ndërsa në inventar janë 73 objekte e konstruksione në regjistrin kontabël të aktiveve rezultojnë 69 objekte me një diferencë 15 objekte, pra konstatohet një mosrakordim prej 4 objekte ndërtimore.

-Nga rakordimi i kryer për vitin 2020 në llogarinë 212 ÷Ndërtesa e Konstruksioneö, midis inventarit të paraqitur dhe regjistrin kontabël të AAGJM, konstatohet se ndërsa në inventar janë 84 objekte e konstruksione në regjistrin kontabël të aktiveve rezultojnë 69 objekte, pra konstatohet një mos rakordim prej 15 objekte ndërtimore.

-Nga rakordimi i kryer për vitin 2020 në llogarinë 215 ÷Mjete Transportiö, midis inventarit të paraqitur dhe regjistrin kontabël të AAGJM, konstatohet se ndërsa në inventar janë 71 mjete në regjistrin kontabël të aktiveve rezultojnë 44 mjete, për konstatohet një mos akordim prej 27 mjete transporti.

Sa sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, datë 10.05.2018 ÷Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiareö, planin kontabël dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të Pasqyrave Financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme".

(Trajtuar hollësisht në faqet 33-63 të të Raportit Përfundimtare të Auditimit).

**25.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të marrë masa dhe të kryejë akordimin e llogarive midis inventarit kontabël dhe fizik, të llogarisë 212 ÷Ndërtesa e Konstruksioneö për 15 objekte ndërtimore, dhe llogarisë 215 ÷Mjete Transportiö për 27 mjete transporti.

**Menjëherë**

**26. Gjetje nga auditimi:** Konstatohet se, për aktivet që dalin nga magazina, flet daljeve, nuk i bashkëlidheshin dokumentet shoqërues si urdhërdorëzime, fletëkërkesat, plani i shpërndarjes e kartelës limit dhe dokumentohen me fletëdaljen të cilat në mjaft raste nuk ishin të nënshkruara nga marrësit në dorëzim, mosveprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 *o*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publiko, Kreu III, pika 38. (Trajtuar hollësisht në faqet 63-88 të të Raportit Përfundimtare të Auditimit).

**26.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), për çdo fletë dalje të bashkëlidhë urdhërdorëzime, fletëkërkesat, plani i shpërndarjes e kartelës limit dhe në çdo rast fletë daljet të nënshkruhen nga marrësi në dorëzim i aktiveve.

#### Në vijimësi

**27. Gjetje nga auditimi:** Nga AKZM, nuk është ndjekur asnjë procedurë administrative për ndjekjen e arkëtimeve nga detyrimet e prapambetura, marrje sipërfaqesh në përdorim në shumën **9,121,759 lekë** për 8 subjekte kontrata të trashëguara ndër vite nga ish/DSHP óte, mos arkëtimi i tyre në kundërshtim me, ligji nr. 44/2015, *o*Kodin e Procedurës Administrative si dhe Ligin nr.10296 datë 08.07.2010, *o*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kreu, II neni 8, germag) garantimin e mbledhjes së të gjitha borxheve të pa arketuar dhe në rastet kur nuk është i mundur të mblidhet ky borxh, duhet të ketë dokumentacion të plotë për të vërtetuar që kryen të gjitha përpjekjet për mbledhjen e tij, me përjashtim të rasteve kur përgjegjësia rregullohet me ligj (Trajtuar hollësisht në faqet 88-95 të të Raportit Përfundimtare të Auditimit).

**27.1.Rekomandim:**Nga AKZM të ndiqen të gjitha rrugët ligjore për te bërë të mundur arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për 8 subjekte në shumën **9,121,759 lekë**, të evidentuara në tabelën si më poshtë vijon.

#### Menjëherë

**28. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se AKZM nuk kishte rregullore për organizimin dhe funksionimin e pikave të hyrjes së vizitorëve dhe automjeteve në monumentin e natyrës syri i kaltër, Parkun Kombëtar Dajt dhe rezervati natyror i menaxhuar Kune Vain. Mungesa e kësaj rregulloreje përbën shkelje të nenit 9, pika 2, dhe nenit 16, pika 2, të ligjit Nr.10 296, datë 8.7.2010 *o*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin *o* (Trajtuar hollësisht në faqet 151-180 të Raportit Përfundimtare të Auditimit).

**28.1.Rekomandim:** Nga AKZM të merren masa për hartimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e pikave të hyrjes së vizitorëve dhe automjeteve në monumentin e natyrës, objekti i rregullores duhet të jetë mbi:

1. Mbajtjen e korrespondencës dhe administrimin e dokumenteve të krijuara apo të ardhura në adresë të Administratave Rajonale të Zonave të mbrojtura. dhe Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura.

2.Përgjegjësitë e AKZM-së dhe AdZM-ve përkatëse në administrimin e këtij procesi. Përcaktimin e procedurës për arkëtimin e të ardhurave nga pikat e hyrjes së vizitorëve dhe automjeteve në zonat e mbrojtura.

#### Menjëherë

**29.Gjetje nga auditimi:** Lidhur me objektin e prokurimit *o*Hartimin i Planit të Menaxhimit të Syri i Kaltër, me fondit limit me vlerë 5,833,333 lekë pa TVSH, u konstatua se Grupi i ngritur hartimin fondit limit nuk ishte kërkuar në ofertat e tregut me analizë të kosto për këtë shërbim. Ndërkohe që duke iu referuar Termave të Referencës zërat e kosto janë të përberë nga Kosto ekspertesh, kosto administrative dhe kosto aktivitetesh.

Veprime në kundërshtim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, *o*Për prokurimin publiko, i ndryshuar, të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, *o*Për rregullat e



prokurimit publikö i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 99-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**29.1.Rekomandimi:**Akzm Njësia e prokurimit të marrë masa që në hartimin e fondit limit të kryej saktë analizë të kostos për këtë shërbim, sipas Termave të Referencës me zërat e kostos të përberë nga Kosto ekspertesh, kosto administrative dhe kosto aktivitetesh.

*Menjëherë*

**30. Gjetje nga auditimi :** Lidhur me objektin e prokurimit ,Furnizim dhe Vendosje bovashe ankoruese me fond limit 19,737.077 lekë pa TVSH,AK ka kërkuar Operatori ekonomik të ketë minimalisht një punonjës zhytës të siguruar e vërtetuar me liste pagese të sigurimeve shoqërore të konfirmuar nga organi tatimorë dhe një certifikatë që vërteton kualifikimin e këtij punonjësi. Sipas kërkesës së bërë nga AK nuk është specifikuar se çfarë lloj certifikatë është dhe as ndonjë cv e punonjësit nëpërmjet të cilës të njihet eksperiencia për të siguruar procesin e montimit dhe vendosjes së bovashe ankoruese,sipas Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, për prokurimin publikö, i ndryshuar, të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, për rregullat e prokurimit publikö, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 99-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**30.1. AKZM** Njësia e prokurimit, ka bërë argumentimi ligjor dhe teknik mbi vendosjen e kriterit pasi mendohet se është i pamjaftueshëm, duke marrë shkas nga tipologjia e punimeve konkrete që do të realizohen (të përfshira në preventivin e punimeve), vlerësojmë se AK nuk ka parashikuar asnjë punim apo veprimtari konkrete për zbatimin e të cilës do të ishte e nevojshme ekspertiza profesionale e inxhinierit, si dhe nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislationit të zbatueshëm për prokurimin publik, veprime në kundërshtim të pikës 1, të nenit 46, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, për prokurimin publikö, i ndryshuar, dhe nenit 26, të Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, për rregullat e prokurimit publikö, i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 99-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**30.2.Rekomandim:**AKZM Tiranë të marrë masa dhe në çdo tender që prokurohet nga Institucioni në dokumentet standarde të përshkruaj sipas objektit të prokurimit specifikimet teknike, në mënyrë që mos të ketë diskriminim të operatorëve ekonomik.

*Menjëherë*

## **C.1.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në 8 raste,për shumën **29,294 lekë**, sipas urdhër-shpenzimeve nr. 289, datë 05.11.2019, nr. 259, datë 09.10.2019, nr.238, datë 09.09.2020, nr.226, datë 02.09.2020, nr.363, datë 23.11.2020, nr.351, datë 18.11.2020, nr.343, datë 13.11.2020, nr.336, datë 10.11.2020, ka likuiduar DRSHTRR-të në rrethe për pagesa gjobash për vonesa, brenda vlerës së përgjithshme, sipas dokumenteve për taksat makine, *gjoba për të cilat duhej të nxirrej përgjegjësia dhe të paguheshin prej personave përgjegjës*,për rrjedhojë nuk duhej të paguhej **shuma prej 29,294 lekë** nga AKZM.

Sa sipër bie në kundërshtim me udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikö (*Trajtuar hollësisht në faqet 63-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e shumës **29,294lekë** sipas urdhër-shpenzimeve nr. 289, datë 05.11.2019, nr. 259, datë 09.10.2019, nr.238, datë 09.09.2020, nr.226, datë 02.09.2020, nr.363, datë 23.11.2020, nr.351, datë 18.11.2020, nr.343, datë 13.11.2020, nr.336, datë 10.11.2020, për pagesa gjobash për vonesa në pagesën e taksave për makinat në DRSHTRR, prej personave përgjegjës për vonesat e shkaktuara.

## Brenda muajit Dhjetor 2021

**2. Gjetje nga auditimi:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në 1 rast, për shumën 150,000 lekë, sipas urdhër-shpenzimit nr.220, datë 02.09.2020, ka likuiduar shoqërinë òXò Shpk, për Shërbim udhëtimi, etj., sipas faturës së thjeshtë tatimore nr. 17, datë 15.03.2020, faturë e cila ka vetëm shënimet: Shërbim udhëtimi, Akomodim, mëngjes, drekë, darkë, sipas Agjendësò, faturë e lëshuar bazuar në urdhrin nr. 57, datë 09.03.2020, të Drejtorit të përgjithshëm, lidhur me organizimin e vizitës së delegacionit të Drejtorisë së Pyjeve të Turqisë. Bashkëlidhur praktikës ndodhet vetëm një program i vizitës në gjuhën angleze, si dhe një e-mail i printuar dërguar prej Drejtorit të Përgjithshëm, ku sqarohet se delegacioni përbëhet nga 3 vetë dhe urdhërohet òpër vënien në dispozicion të fugonit dhe të pagesave të drekave/darkave sipas programitò.

Urdhri nr.57, datë 09.03.2020 I referohet edhe VKM nr. 243, datë 15.05.1995 òPër shpenzimet për pritje-përcjellje të delegacioneve të huajaò, i ndryshuar.

*Në dosje ndodhet vetëm programi në gjuhën angleze dhe mungojnë dokumentet vërtetuese analitike të shpenzimeve të kryera.*

*Kështu nuk është përcaktuar klasa dhe grupi i delegacionit (i parë, i dytë, i tretë) për të vendosur mbi normën ditore të ushqimit për secilin anëtar të delegacionit, nuk ka situacione të shpenzimeve ditore të kryera për delegacionin prej 3 personash, mungojnë dokumentet e akomodimit në hotele, të udhëtimit dhe shpenzime të tjera të kryera.*

Theksojmë se sipas programit disa dreka dhe darka janë planifikuar të mbulohen dhe ofertohen prej subjekteve të ndryshme, për datën 10, 13, 14/03.2020.

Sa sipër është në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1995 òPër shpenzimet për pritje-përcjellje të delegacioneve të huajaò, i ndryshuar dhe udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e Sektorit Publikò, neni 36 (*Trajtuar hollësisht në faqet -33-68 të Raportit Përfundimtarët Auditimit*).

**2.1. Rekomandim:** Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve të Brendshme), të ndjekë të gjithë rrugët ligjore për arkëtimin e shumës 150,000 lekë, prej përfituesit òXò Shpk, për shpenzime të paargumentuara dhe antiligjore, në të kundërt shuma të ç dëmtohet nga personat përgjegjës.

## Brenda muajit Dhjetor 2021

### **C.2. TË ARDHURA TË MUNGUARA**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se AKZM ka trashëguar nga Ish/DSHPT dhënie sipërfaqësh në përdorim dhe administron **8 kontrata** për të cilat nuk është përmbushur detyrimi kontraktuar nga subjektet, duke i shkaktuar buxhetit të Ministrisë së Turizmit të ardhur të munguar në vlerën **9,121,759 lekë**. (*Trajtuar hollësisht në faqet 88-95 të të Raportit Përfundimtarët Auditimit*).

**1.1.Rekomandim:** AKZM të marrë masa për njoftimin dhe arkëtimin e detyrimeve nga 8 subjekte në vlerën 9,121,759 lekë *respektivisht:* detyrimeve të prapambetura për 8 subjekte në shumën 9,121,759 lekë, të trashëguara nga Ish/DSHPT evidentuara si më poshtë.

Subjekti x ne vlerë	1,440,000 lekë,
Subjekti x në vlerë	2,700,000 lekë,
Subjekti x në vlerë	67,448 lekë,
Subjekti x në vlerë	546,648 lekë,
Subjekti x në vlerë	1,886,580 lekë,
Subjekti x ne vlerë	28,000 lekë
Subjekti x ne vlerë	44,083 lekë
Subjekti x ne vlerë	2,409,000 lekë,

**Menjëherë**

### **C.3. MASA PËR ELEMENIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1.Gjetje nga auditimi:**Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, në 4 raste për shumën e përgjithshme **3,132,776lekë**, si rezultat i dhënies së masave ekstreme disiplinore të largim nga Shërbimi Civil si dhe zgjidhjes së kundërligjshme të kontratave të punonjësve të pabazuara në Kodin e Punës, kanë sjellë kundërpërgjigje nga punonjësit e institucionit të cilët kanë bërë padi në gjykatë ku kanë fituar të drejtën e tyre edhe në shkallën e dytë të gjykimit dhe për pasojë nga shteti janë shpenzuar **3,132,776lekë** për kompensimin e punonjësve të larguar padrejtësisht, duke shkaktuar efekte ekonomike negative në administrimin e fondeve publike. Sa sipër është vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës I Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (Trajtuar hollësisht në faqet 63-88 të të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandim:**Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e rasteve, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me efekt negativ për vlerën **3,132,776leke**, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për shërbimin civil okrijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike si kodit të punës.

### **D.MASA DISIPLINORE**

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, në zbatim të nenit 58, të llojet e masave disiplinore të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2017 për nëpunësin civil, i ndryshuar me ligjin nr.178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr.115, datë 05.03.2014 për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendim-marrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, në Kreu IV, neni 11 germa 1 dhe 2 dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 të Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, ligjit nr.81/2017 për Zonat e Mbrojtura, si dhe në kontratën kolektive dhe individuale të punës i rekomandojmë **Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktortë vlerësojë**, për personat përgjegjës të aplikojë marrjen e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim”, në varësi të analizës së përgjegjësive, për secilin punonjës për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

*Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit.*

---

**K R Y E T A R**

**Arben SHEHU**

